

Në klinikat e shkollave, ju kushtojmë kohë me kënaqësi për nevojat tuaja.

Ofertat tona janë në dispozicion të të gjithë fëmijëve dhe të rinjve të shkollave fillore të qytetit të Cyrihut, si dhe prindërve të tyre e personelit mësimor dhe janë normalisht pa pagesë. Punonjësit e tyre janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e informacionit. Informacione të tjera i gjeni në: www.stadt-zuerich.ch/schularzt

Ku mund ta gjej klinikën e shkollës sime?

1 Schulkreis Uto

Seestr. 346, 8038 Zürich
Tel. 044 413 41 30

2 Schulkreis Letzi

Lindenplatz 4, 8048 Zürich
Tel. 044 413 46 10

3 Schulkreis Limmattal

Langstr. 21, 8004 Zürich
Tel. 044 413 46 41

4 Schulkreis Waidberg

Rotbuchstr. 42, 8037 Zürich
Tel. 044 413 46 00

5 Schulkreis Zürichberg

Wildbachstr. 70, 8008 Zürich
Tel. 044 413 46 90

6 Schulkreis Glattal

Oberwiesenstr. 66, 8050 Zürich
Tel. 044 413 46 83

7 Schulkreis Schwamendingen

Dübendorferstr. 5, 8051 Zürich
Tel. 044 413 46 75



Stadt Zürich
Schulgesundheitsdienste
Schulärztlicher Dienst
Parkring 4, Postfach
8027 Zürich
Telefon 044 413 88 95
sg-sad.info@zuerich.ch

www.stadt-zuerich.ch/schularzt



Stadt Zürich
Schulgesundheitsdienste

Schulärztlicher Dienst

Ofertat e shërbimit mjekësor të shkollës në qytetin e Cyrihut

Të shëndetshëm gjatë kohës së shkollës



Sepse shëndeti është një gjë e vlefshme ...

Kujdesi për shëndetin e fëmijëve është një ndër të drejtat themelore të tyre. Në fëmijëri hidhen bazat për një shëndet sa më të mirë në të ardhmen. Krahas prindërve edhe shkolla angazhohet që të ndikojë në forcimin e sjelljeve të shëndetshme dhe ndërgjegjësimin e fëmijëve për shëndetin. Këtu përfshihen, ndër të tjera, edhe ofertat e shërbimit mjekësor të shkollës. Me synimin për të ofruar shanse të barabarta për sa i përket shëndetit, shërbimi mjekësor i shkollës mbështet një zhvillim sa më të shëndetshëm të të gjithë fëmijëve në moshë shkollë, nga kopshti, deri në nivelin sekondar. Në dispozicion të prindërve, nxënësve dhe shkollave vendosen ofertat e mëposhtme:

Tre kontrollë mjekësore parandaluese nga shërbimi mjekësor i shkollës

Për çdo fëmijë duhet të krijohen kushte sa më të favorshme për ta kaluar sa më mirë periudhën e shkollës. Për këtë arsye, në shkollën fillore ligji parashikon tre kontrollë nga shërbimi mjekësor i

shkollës për të gjithë nxënësit. Ata kryhen në vitin e parë të kopshtit, në klasën e pestë dhe në vitin e dytë të nivelit sekondar. Qëllimi i këtyre kontrolleve është të identifikohen sa më

herët rreziqet që mund t'i kanojnë shëndetit dhe zhvillimit të fëmijëve, në mënyrë që të merren në kohën e duhur masat përkatëse, nëse është e nevojshme.

Mbrojtja nga sëmundjet ngjitëse

Fruthi, kolla e mirë, meningjiti purulent, etj.: Nëse, në një shkollë, shfaqen sëmundje të tilla, atëherë marrim masa të posaçme për të parandaluar një përhapje më të gjerë të tyre.

Mbrojtja nëpërmjet vaksinimit

Vaksinimi është mënyra më e mirë për të mbrojtur veten dhe të tjerët nga një numër i madh sëmundjesh infektive. Ne kontrollojmë vaksinimin e të gjithë fëmijëve dhe, në rast se dëshironi, ofrojmë vaksinim pa pagesë.

Kurse të veçanta për lëvizje

Fëmijët që lëvizin shumë flenë më mirë, mund të përqendrohen më mirë në shkollë dhe janë më të ekuilibruar emocionalisht. Në përgjithësi, është shumë e rëndësishme për zhvillimin e shëndetshëm të fëmijëve që ata të lëvizin shumë. Për fëmijët që kanë pak përvojë lëvizjeje ose që janë mbipeshë, ofrojmë kurse të veçanta për lëvizje. Qëllimi i këtyre kurseve pa

pagesë është që fëmijët të nxitin për të zbuluar gëzimin dhe kënaqësinë që sjell lëvizja. Më shumë informacione i gjeni në: www.stadt-zuerich.ch/schularzt

Këshillimi nga mjekët e shkollës

Nëse prindërit kanë pyetje lidhur me shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës së tyre, në kontekstin e shkollës, ata mund t'i drejtohen për këshillim shërbimit mjekësor të shkollës.

Këshillim individual për të ushqyerit

Shqetësoheni për peshën e fëmijës suaj? Keni pyetje dhe diskutoni në familje lidhur me të ushqyerit e fëmijës suaj? Programi i këshillimit për ushqimin i shërbimit mjekësor të shkollës u ofron prindërve dhe fëmijëve këshillime individuale. Më shumë informacione i gjeni në: www.stadt-zuerich.ch/schularzt

Edhe pse më sëmundje kronike, të sigurt gjatë kohës së shkollës

Ne këshillojmë dhe mbështesim si shkollën, ashtu edhe prindërit që kanë fëmijë me sëmundje kronike. Këtë e bëjmë veçanërisht kur në shkolla apo qendra të kujdesit pas shkollës nevojitet marrja e masave të caktuara (p.sh. dhënia e medikamenteve).

Mbrojtja e fëmijëve

Ne angazhohemi për mbrojtjen e fëmijëve, në mënyrë që ata dhe të rinjtë të rriten të padëmtuar fizikisht dhe emocionalisht.

Përgatitja e informacioneve

Shërbimi mjekësor i shkollës ofron broshura informative për tema të ndryshme. P.sh.: "Të shëndetshëm dhe në formë falë lëvizjes së rregullt", "Fruthi", "Trajtimi i parazitëve të kokës", "A është fëmija im gati për në kopsht? Kriteret sipas këndvështrimit të mjekëve të shkollës", "Këshilla për përdorimin e mjeteve mediatike të fëmijët e kopshtit", "Çanta shkolle të përshtatshme", "Informacione dhe këshilla për vaktin e mëngjesit dhe të paradites", etj.. Këto broshura informative i gjeni në: www.stadt-zuerich.ch/schularzt

